



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1205/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Fadil Spahiu, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e LVV-së në Lipjan, paraqitur kundër Qendrës të Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Fadil Spahiu kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Lipjan, nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:13 nga Fadil Spahiu kandidat për anëtar të kuvendit komunal, ku ka pretenduar për mospërputhje të votave sipas këtyre qendrave të votimit:

1307E – Gadime – 01R, 02R, 03R, 04R, 05R, 06R, 07D

1308E – Llugagji – 03D, 02R, 01R,

1326E – Krojmir – 01R, 02R,

1306E – Babush – 01R, 02R, 03R, 04R, 05D,

1327E – Poturovc – 01R, 02D,

1301X – Lipjan – 02R, 03R, 04D

1325E – Lipjan – 01R, 02R, 03R, 04D.

Pretenduesi i ankesës kërkon që të bëhet rinumërimi i votave në kutitë e lartpërmendura.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi dhe nuk e ka specifikuar numrin e votave të munguara siç pretendon në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën e kandidatit Fadil Spahiu për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e LVV-së, konstatoi se pretendimet ankimore nuk janë të argumentuara në fakte konkrete dhe dëshmi, pasi që ankesës nuk i është

bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse me qëllim të vërtetimit të shkëljes së supozuar. Andaj, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesa vlerësohet si e pa bazë, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa

Anr. 1205/2013 më datën 06.12/2013



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.